REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

| Pranuar / Dorezuar Primljeno/Prodato Recieved/Delivery | 24.10.2022 | | viti god year |
|---|---|---|---|
| Organ./Njesia Organ./Jedinica Org./Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKPMSHK | 6417/2022 | | 1/6 |

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI *I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS*
*NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA*
*INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA*

**A.nr.784/2022**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.784/2022 të datës 09.09.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi në Prishtinë, kundër organit të punësimit Policia e Kosovës, në çështjen juridike *"kontestim konkursi"*, duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 24.10.2022, një zëri mori këtë:

**V E N D I M**

**I.** ***Refuzohet si e pabazuar*** ankesa A.nr.784/2022 e datës 09.09.2022 e parashtruar nga ankuesi

**II.** ***Mbetet në fuqi*** Vendimi Nr.Reference: 07/1-01SAP-R/580/2022 i datës 01.09.2022 të Drejtorit të Drejtorisë së Personelit të Policisë së Kosovës.

**A r s y e t i m**

Ankuesi me datë 09.09.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5257/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës kundër vendimit Nr. Reference 07/1-01SAP-R/580/2022 të datës 01.09.2022 të Drejtorisë së Personelit në Policinë e Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 12.09.2022 ka proceduar kërkesën me numër të protokollit 5326/2022 për përgjigje në ankesë në Policinë e Kosovës. Ndërsa Këshilli, me datë 19.09.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me provat lidhur me çështjen ankimore në vendosje.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova**: Ankesën me numër protokolli të datës 09.09.2022 të parashtruar nga ankuesi Dosja e ankuesit si : Kopjen e Letërnjoftimit; Diplomën e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" me Nr.897 të datës 05.07.2018; Certifikatën e Notave me Nr. të dosjes:190808200018 të datës 02.09.2022; ID-në me nr.190808200018; Ankesën e datës 25.08.2022; E-mailin e dërguar nga SIMBNJ për e datës 23.08.2022; E-mailin e dërguar nga për të datës 23.08.2022; Vendimin me Nr. të Referencës:07/I-0ISAP-R-575/2022 të datës 23.08.2022; E-mailin e dërguar nga SIMBNJ për të datës 01.09.2022; E-mailin e dërguar nga për të datës 01.09.2022; Vendimin me Nr. të Referencës 07/I-0ISAP-R/580/2022 të datës 01.09.2022; Konkursin për Zyrtar të Lartë për Infrastrukturë Rrugore me Nr. të referencës RN00009456 të datës 20.07.2022; Vërtetimin e Punësimit me Nr.të referencës 07/1-01SAP-/6029 të datës 01.08.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë menuemr te protokollit 5326/2022 të datës 12.09.2022; Përgjigje në Ankesë me numër të protokollit 5485/2022 të datës 19.09.2022; Kërkesën për aprovim dhe fillimin e procedurës për shpalljen e konkursit të brendshëm-Lëvizje Brenda Kategorisë me nr.referencës 07/1-01/103/2022; Konkursin për Lëvizje brenda kategorisë me nr. të Referencës RN00009456 të datës 20.07.2022; Listën e aplikanteve nga SIMBNJ; Njoftimin nga Drejtoria e Personelit me nr. të referncës:07/I-0-ISAP-R/588/2022 të datës 01.09.2022; Aplikacionin e ankuesit të datës 15.08.2022; Kërkesën për të drejtën e fillimit të procedurës se temës master drejtuar Këshillit të Fakultetit nga me nr. protokolli 1715 të datës 24.12.2021; Paraqitjen e propozimit të temës së masterit nga të datës 24.12.2021; Përmbajtjen e temës së masterit; Punim Masteri( pa nr. protokolli dhe pa datë); Kërkesën për formimin e Komisionit për vlerësimin e projekt propozimit të punimit të diplomës master të datës 24.12.2022; Biografinë e Kandidatit , Shkollimin , Trajnimet e kryera , Punësimet të ankuesit; Certifikatën e Notave me nr. reference 991 të datës 16.11.2021; Certifikatën e për pjesëmarrje në trajnimin për Menaxhimin dhe organizimin e zyrës nga 28 deri më 29 prill 2009; Certifikatën e datës 13.05.2011; Certifikatën e lëshuar nga OSCE të datës 30.03.2012; Certifikatën e për trajnimin në shkathtësitë e komunikimit të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme respektivisht Policia e Kosovës me nr.312/2019; Letrën Referimin të lëshuar nga Policia e Kosovës më datën 15.08.2022; Mirënjohjen të lëshuar nga Policia e Kosovës e vitit 2014; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesëm, i Ulët dhe Profesional të datës 13.01.2022; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesëm, i Ulët dhe Profesional të datës 15.01.2022; Vërtetimin të lëshuar nga Policia e Kosovës me nr. reference 07/1-01SAP-P/6017 të datës 29.07.2022; Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore Prishtinë me nr.14357/2022 të datës 04.07.2022; Dosjen e të datës 11.08.2022; Diplomën mbi shkallën e përgatitjes profesionale; Vendimin me nr. reference 2/6-2342 të datës 16.02.2016; Diplomën Master Profesional ne Planifikim Transporti, Menaxhim Trafiku dhe Siguri Rrugore të Universitetit Politeknik të Tiranës me nr. Diplome MP-56,nr.amze:81 të lëshuar më datën 04.02.2015; Diplomën e Fakultetit të Komunikacionit Rrugor dhe Transportit të Studimeve Themelore Universitare të Kolegjit Tempulli me nr. protokolli 153/10 të datës 01.11.2010; Certifikatën e Qendrës për Zhvillim Profesional të Kolegjit Tempulli me nr.025/11-PP të datës 15.11.2011; Certifikatën për pjesëmarrjen në trajnimin Kontrolli dhe Monitorimi i Projekteve të lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike të datës 9,10,11 mars 2022; Certifikatën

për pjesëmarrjen në trajnimin Planifikimi dhe Vendimmarrja të lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike të datës 18,19 mars 2019; Certifikatën për pjesëmarrjen në trajnimin Motivimi dhe Udhëheqja e Punonjësve të lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike të datës 26,27 shkurt 2018; Kopjen e Letërnjoftimit; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesëm, i Ulët dhe profesional të datës 20.01.2022; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesëm, i Ulët dhe Profesional të datës 29.01.2021; Vërtetimin e lëshuar nga Policia e Kosovës me nr. reference 07/1-01SAP-P/5926 të datës 28.07.2022; Vërtetimin e Punësimit të lëshuar nga Policia e Kosovës me nr. reference 07/1-0SAP-P/5938 të datës 29.07.2922; Certifikatën e Lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë me nr.5085/2022 të datës 08.08.2022; Dosjen e Aplikacionin e të datës 13.08.2022; Certifikatën e Kolegjit Tempulli me nr. protokolli 43/2006 të datës 08.12.2006; Diplomën e Kolegjit Tempulli me nr.043 të datës 16.03.2007, Vërtetimin e Punësimit të Sh.M.E "Gjin Gazulli" Prishtinë me nr. protokolli 58 të datës 21.10.2010; Aktvendimin e lëshuar nga Prokurori i Shtetit me nr. protokolli 5540/13 të datës 09.09.2013; Vërtetimin për statusin e studentit Master nga kolegji Globus për me nr. protokolli 179 të datës 07.12.2011; Certifikatën e Trajnimit të Ndihmës së Parë nga Qeveria e Kosovës të datës 09-13.12.2013; Certifikatën për Trajnimin në Motorola Israel për muajit Shkurt 2006; Mirënjohje nga Drejtoria Rajonale e Policisë Prishtinë të vitit 2022; Certifikatën për Pjesëmarrjen në Trajnimin Ngritja e Kapaciteteve dhe Shkathtësive të Buta të datës 13.12.2019; Certifikatën e Pjesëmarrjes nga Komuna e Prishtinës të datës 26.12.2020; Certifikatën nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për të datës 15.07.2005; Certifikatën nga Ministria e Punëve të Brendshme të datës 30.11-04.12.2009; Certifikatën e Consulting AR me nr. protokolli 24/22 të datës 16/17.05.2022; Certifikatën nga Turkish National Police-Communication Departament të datës 15-26.12.2008; Vërtetimin e Punësimit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës me nr. reference 04/1-01SRR/2789 të datës 30.06.2022; Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës me nr. reference 07/1-01SAP-P/6631 të datës 10.08.2022; Formularin për vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike të datës 12.01.2021; Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të datës 15.01.2021; Kopjen e Letërnjoftimit; Dosjen e Aplikacionin e datës 10.08.2022; Diplomën për kryerjen e Shkollës së Mesme të Lartë Profesionale "Hoxhë Kadri Prishtina " në Prishtinë të datës 17.09.2012; Diplomën e Kolegjit AAB në Administratë Publike me nr. protokolli 999/18 të datës 07.07.2018; Certifikatën e lëshuar nga Policia e Kosovës të datës 10.05-13.05.2022; Certifikatën e lëshuar nga Divizioni i Trajnimeve në Policinë e Kosovës me nr. protokolli 918/2019 të datës 22.02.2019; Certifikatën e lëshuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës të datës 15.05.2017-19.05.2017; Certifikatën e lëshuar nga OSCE për të datës 19.09.2016-23.09.2016; Kontratën e Punës për Kohë të Pacaktuar e lëshuar nga Policia e Kosovës për me nr. referencë 07/1-01A/0454 të datës 03.07.2014; Kopjen e Letërnjoftimit; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesëm, i Ulët dhe Profesional të datës 17.01.2022; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesëm, i Ulët dhe Profesional të datës 25.01.2020; Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës me nr. reference 07/1-01SAP-P/6514 të datës 04.08.2022; Mirënjohjen e lëshuar nga Komanda Regjionale Prishtinë-Stacioni Fushë Kosovë të datës 15.01.2008; Letër Falënderimi të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e

Policisë se Kosovës, Stacioni Policor Veriu në muajin Shkurt 2014; Mirënjohjen e lëshuar nga Policia e Kosovës, Stacioni i Veriut të datës 05.02.2019; Letër Rekomandimi të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës; Vendimin e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës me nr. reference PK/DP/AP/4129 të datës 15/04/2010; Vendimin e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës për me nr. reference 07/1-01A/3142 të datës 07/05/2014; Vendimin për Caktim të lëshuar nga Drejtoria e Personelit të SHPK-së Prishtinë me nr. reference KPS/DP/AP/7616/D të datës 18.09.2007; Dosjen e kandidatit Aplikacionin e datës 09.08.2022; Diplomën e Kolegjit ISPE në Programin Juridik me nr.D-839/20 të datës 04.08.2020; Vërtetimin e kopjes nga origjinali të Diplomës me LRP nr.8596/2020 të datës 20.08.2020; Certifikatën e lëshuar nga Ministria e Financave Departamenti i Thesarit të datës 17.07.2012; Kontratën e Marrëdhënies së Punës të lëshuar nga Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal me nr.105/1 të datës 01.07.2008; Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit të lëshuar nga Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal të datës 20.01.2014; Vendimin e lëshuar nga Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal me nr. protokolli 112-689 të datës 02.08.2022; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesëm, i Ulët dhe Profesionalë të datën 10.10.2021; Kopjen e Letërnjoftimit; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesëm, i Ulët dhe Profesionalë të datës 20.01.2021; Vërtetimin e lëshuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal të datës 07.07.2022; Dosjen e kandidatit Aplikacionin e të datës 04.08.2022; Diplomën e Kolegjit për Biznes Programi Menaxhimi i Emergjencave me nr. protokolli 122/15 të datës 19.08.2015; Diplomën e Kolegjit për Biznes grada Master i Arteve në Menaxhimin e Emergjencave me nr. protokolli 15/20 të datës 13.03.2020; Kopjen e Letërnjoftimit; Vërtetimin e lëshuar nga Policia e Kosovës të datës 29.07.22; Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore Prishtinë me nr. protokolli 4872/2022 të datës 28.07.2022; Vërtetimin e lëshuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore në Podujevë me nr. Protokolli 13-204/2022 të datës 29.07.2022; Vërtetimin e lëshuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore në Podujevë për me nr. Protokolli 13-201/2022 të datës 26.07.2022; Akt Emërimin e datës 01.02.2019; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesëm, i Ulët dhe Profesionalë të datës 24.01.2022; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike të datës 02.12.2020; Noterizimin e lëshuar nga S.V Noter lidhur me noterizimin e Diplomës LRP,nr.3343/2020 të datës 18.06.2020; Kopjen e Letërnjoftimit; Kopjen e Patentë Shoferit; Diplomen me numër 15/20 të datës 13.03.2020;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku ka konstatuar se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar së Policia e Kosovës me datë 20.07.2022 ka shpallur Konkursin lëvizje brenda kategorisë me numër reference RN00009456 për pozitën "*Zyrtar i Lartë për Infrastrukturën Rrugore*" klasa profesional 1, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, por që të njëjtit në fazën e verifikimit paraprak me Vendimin Nr. Reference 07/1-01SAP-R/575/2022 të datës 23.08.2022 të Drejtorit të Drejtorisë së Personelit të Policisë së Kosovës i është refuzuar aplikacioni për shkak se ankuesi nuk ka plotësuar kriterin e arsimit

rrjedhimisht ka vetëm diplomë universitare me 180 kredi, kështu që ankuesi nuk është përfshirë në listën e ngushtë.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin Nr.Reference 07/1-01SAP-R/575/2022 të datës 23.08.2020 ka parashtruar ankesë të brendshme me datë 25.08.2022, e cila me Vendimin Nr.Reference 07/1-01SAP-R/580/2022 të datës 01.09.2020 të Drejtorit të Drejtorisë së Personelit të Policisë së Kosovës i është refuzuar si e pa bazuar ankesa po me arsyetim të njëjtë se ankuesi nuk ka plotësuar kriterin e arsimit.

Ankuesi brenda aftit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se i është bëre e pa drejtë nga organi i punësimit me rastin e refuzimit të aplikacionit për pozitën e punës *"Zyrtar i Lartë për Infrastrukturë Rrugore"*, sepse i njëjti pretendon se i ka plotësuar kriteret e konkursit dhe për ketë ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme si Diplomën me Nr.897 e datës 05.07.2018 e cila ka në total 180 kredi / ECTS, si dhe certifikatën e notave të nivelit mastar me 90 kredi/ECTS i cili konsideron se është ekuivalente sepse në konkurs kërkohen numri i kredive prej 240 kredi/ECTS.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore ka analizuar Konkursin lëvizje brenda kategorisë me numra reference RN00009456 për pozitën *"Zyrtar i Lartë për Infrastrukturën Rrugore"* dhe rrjedhimisht ka gjetur se si kritere të përgjithshme formale janë përcaktuar: **Arsimi i kërkuar**: *Diplomë/a të studimeve universitare të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to, drejtimi komunikacion rrugor;* ***përvoja e punë:*** *se paku tre (2) vite përvojë pune profesionale në fushën në të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës se lire të punës.* Andaj, nisur nga këto kritere si dhe bazuar ne analizimin e dokumentacionit të aplikimit të ankuesit Kolegji ka konstatuar se i njëjti sipas diplomës me Nr.897 të datës 05.07.2018 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" ka përfunduar studimet themelore me datë 02.07.2018 dhe ka marrë titullin Bachelor i Inxhinierisë Mekanike me gjithsej 180 kredi/ECTS, ndërsa lidhur me studimet master posedon certifikatën e Notave me nr. reference 991 të datës 16.11.2021 të lëshuar nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike të Universitetit "Hasan Prishtina" si dhe kërkesën më numër të protokollit 1715 të datës 24.10.2021 për të drejtën e fillimit të procedurës se temës se masterit, e mbi bazën e këtyre dëshmive Kolegji konstaton së janë të pa bazuara pretendimet ankimore të ankuesit, rrjedhimisht ankuesi nuk ka plotësuar kriterin e arsimit, pasi që i njëjti nuk posedon diplome universitarë me 240 kredi/ECTS.

Gjegjësisht Kolegji i Këshillit vlerëson së Certifikata e Notave të masterit e dorëzuara nga ankuesi me rastin e aplikimit mund të shërbej si dëshmi për nevoja të brendshme të Fakultetit, gjegjsisht Universitetit, por jo edhe për nevoja të punësimit, sepse me dispozitat e Statutit të Universitetit të Prishtinës, përkatësisht nenin 135 percaktohet se: *Përfundimi i suksesshëm i studimeve në përputhje me programin e studimeve vërtetohet nga Universiteti përmes diplomës që është dokument zyrtar.*

Andaj, bazuar si me sipër Kolegji konstaton së Drejtori i Drejtorisë së Personelit në Policinë e Kosovës me rastin e nxjerrjes se Vendimit Nr.Reference:07/1-07SAP-R/575/2022 të datës 23.08.2022 si dhe Vendimit Nr.Reference: 07/1-01SAP-R/580/2022 të datës 01.09.2022 ka vërtetuar drejte dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe rrjedhimisht ka vepruar ne pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 45

paragrafi 5 më të cilin është përcaktuar se: "... *Kandidatët, që nuk plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin...*".

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit pas analizimit të shkresave të lëndës dhe duke qenë së nuk janë konstatuar shkelje procedurale dhe materiale lidhur me ketë çështje administrative, bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike**: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**
**Lënda me numër A.nr.784/2022.**

**Avdyl BEKTESHI**
*Procesmbajtës*

**Ardita Haxhnikaj-DEMI**
*Kryetare e Kolegjit*

**Vendimi i dërgohet:**

- *Ankuesit*
- *Drejtorit të Përgjithshëm në Policinë e Kosovës;*
- *Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Policin e Kosovës; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*